



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



P1 110/04-16337
06.07.2017

RREGULLORE

PËR

**PËR ORARIN E PUNËS SË VEPRIMTARIVE AFARISTE DHE
OJQ-ve NË KOMUNËN E GJAKOVËS**

Gjakovë 2017

Kuvendi i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 12. 2 shkronja (c) dhe nenit 40.2 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, dhe nenit 18.2 shkronja (a) të Statutit të Komunës së Gjakovës dhe në mbështetje të Ligjit nr. 2004/18 dhe Plotësim Ligjit nr. 04/L-005 për Tregtinë e Brendshme dhe Udhëzimit administrativ nr. 2007/03, për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës në lëmin e tregtisë dhe format tjera të organizmit të tregtisë, në mbledhjen e mbajtur me dt. 04.07.2017 , pas diskutimeve në pikën e 4 të rendit të ditës : Shqyrtimi i Draft Rregullore për Orarin e Punës së Veprimtarive Afariste dhe OJQ-ve në Komunën e Gjakovës, e miratoj këtë :

RREGULLORE

PËR

ORARIN E PUNËS SË VEPRIMTARIVE AFARISTE DHE OJQ-ve NË KOMUNËN E GJAKOVËS

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet fillimi dhe mbarimi i orarit të punës për veprimtarit afariste dhe OJQ-të të cilat veprojnë në territorin e Komunës së Gjakovës.

Neni 2

Veprimtarit afariste, në pajtim me Nenin 1 të kësaj Rregullore, janë të obliguara ti përmbahen orarit të punës të përcaktuar me këtë Rregullore.

Neni 3

3.1 Orari i punës nënkupton periudhën kohore të fillimit dhe mbarimit të punës.

3.2 Orari i punës i përcaktuar me këtë Rregullore, duhet të vendoset në hyrje apo në vend të dukshëm të objektit në të cilin ushtrohet veprimtaria afariste, duke saktësuar fillimin dhe mbarimin e orarit të punës, ditët që nuk punohet, rastet e veçanta, si dhe pauzën ditore.

Neni 4 Orari i Punës

4.1. Orari i punës përcaktohet në bazë të dy periudhave, në atë verore dhe dimërore, në intervale kohore:

- a. periudha verore fillon më 1 Prill dhe mbaron më 30 Shtator të vitit;
- b. periudha dimërore fillon më 1 Tetor dhe mbaron më 31 Mars të vitit

Neni 5

5.1. Orari i punës në dyqanet të ondulimit dhe floktoreve është:

- a. periudha verore, prej orës 06:00 - 21:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 06:00 - 20:00

5.2. Orari i punës në furrat e bukës dhe pjekurinave për aktivitetet e shitjes është:

- a. periudha verore, prej orës 07:00 - 23:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 22:00

5.3. Furrat e bukës për përgatitjen dhe prodhimin e bukës dhe pjekurinave të tjera janë të lejuara të fillojnë punën prej orës 04:00.

5.4. Orari i punës për gjellëtore, qebaptore dhe pastiçeritë është:

- a. periudha verore, prej orës 07:00 - 23:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 22:00

5.5. Orari i punës për autolarjet është:

- a. periudha verore, prej orës 08:00 - 21:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 18:00.

5.6. Orari i punës në dyqanet tjera zejtare:

- a. periudha verore, prej orës 08:00 - 20:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 18:00

5.7. Ditën e fundjavës (të Dielën) dyqanet zejtare nuk do të punojnë, përveç salloneve të ondulimit, floktoreve, dhe furrat e bukës;

5.8. Veprimtarit që merren me artizanate të cilat gjinden në Çarshinë e Madhe për shkak të natyrës së rëndësishme në promovimin e trashëgimisë kulturore dhe turizmit, në pajtim paraprak me organet kompetente të Komunës mund të punojnë çdo ditë me orar fleksibil gjatë tërë vitit.

Neni 6

6.1. Orari i punës në dyqanet ushqimore, supermarkete, qendrat tregtare dhe kiosqet është i njëjtë në të dy periudhat duke filluar prej orës 08:00 - 23:00.

6.2. Orari i punës në dyqanet jo ushqimore do të jetë:

- a. periudha verore, prej orës 08:00 - 21:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 20:00

6.3. Ditën e fundjavës (e Diele) të gjitha veprimtarit të përshkruara në pikën 6.1 të këtij Neni, mund të punojnë në orarin e njëjtë sikurse ditët tjera të javës.

6.4. Veprimtarit jo ushqimore të përshkruara në paragrafin 6.2 të këtij Neni, nuk do ushtrojnë veprimtarinë ditën e Diele.

Neni 7

7.1. Orari i punës në depot e artikujve ushqimor, depot e materialit ndërtimor dhe në ndërmarrjet që merren me prodhimin e betonit:

- a. periudha verore, prej orës 08:00 - 20:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 18:00

7.2. Ditën e fundjavës (të Dielën) depot punojnë prej orës 08:00 deri në orën 15:00 gjatë të dy periudhave;

7.3. Orari i punës në ndërmarrjet ndërtimore (ndërtimi i ulët dhe i lartë):

- a. periudha verore, prej orës 07:00 - 18:00.
- b. periudha dimërore, prej orës 08:00 - 17:00

Neni 8

8.1. Orari i punës në kafene është i njëjtë në të dy periudhat dhe fillon prej orës 07:00 - 24:00.

8.2. Orari i punës në disko-klube është i njëjtë në të dy periudhat dhe fillon prej orës 18:00 - 24:00.

8.3 Veprimtarit afariste të cekura në paragrafin 8.1 dhe 8.2 të këtij Neni, gjatë orarit të rregullt të punës mund të përdorin muzikë deri në orën 23:00, gjithmonë në pajtim me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike, si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma.

8.4 Orari i punës në të gjitha veprimtarit hoteliere dhe restorante është i njëjtë në të dy periudhat dhe fillon prej orës 07:00 - 24:00.

8.5. Hotelet dhe Motelet mund të punojnë pandërprerë vetëm me shërbime të fjetjes, mirëpo duke kufizuar të gjitha shërbimet tjera (restorant, bar, etj.) pas orarit të caktuar me pikën 8.4

Neni 9

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit brenda juridiksionit të saj do të përcaktojë cilat janë zonat urbane dhe para - urbane duke u bazuar në Rregulloren për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale numër 01.nr.011-43964 të datës 06.07.2015.

Neni 10

10.1. Orari i punës për internet-kafe, bastore dhe veprimtari tjera rekreative është i njëjtë në të dy periudhat dhe fillon prej orës 08:00 - 23:00.

10.2. Stadiumet e improvizuara të futbollit, palestrat sportive dhe veprimtarit që merren me shërbime funerale punojnë pa kufizime.

10.3. Orari i punës për pishina të hapura është i lejuar për stinën e verës prej orës 10:00 -20:00.

Neni 11

11.1. Orari i punës në tregjet e qytetit:

- a. periudha verore, prej orës 06:00 - 23:00;
- b. periudha dimërore, prej orës 07:00 - 21:00.

11.2. Tregu i madh punon ditëve të Hëna të çdo jave prej orës 06:00 deri 18:00.

11.3 Tregjet të cilat janë të dhëna në shfrytëzim nëpërmjet Vendimeve të Asamblesë Komunale apo Ndërmarrjeve Publike Lokale, orari i punës dhe ditët e punës, janë të rregulluara sipas kontratës së nënshkruar në partneritet publiko privat.

Neni 12

12.1. Pikat e shitjes së karburanteve mund të punojnë 24 orë (pandërprerë) dhe është i njëjtë në të dy periudhat.

12.2. Kafenetë dhe restorantet që operojnë në pikat e shitjes së karburanteve mund të punojnë deri në orën 02:00 me pëlqim paraprak nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Neni 13

13.1. Orari i punës në barnatore, labororët dhe ordianca private është i njëjtë në të dy periudhat dhe fillon prej orës 07:00 deri në orën 24:00.

13.2. Në raste emergjente, të Dielave dhe gjatë festave Shtetërore, veprimtaritë afariste të cekura në paragrafin 13.1 të kësaj Rregullore, mund të punojnë edhe jashtë orarit.

13.3. Barnatoret që veprojnë në qytet në afërsi të shërbimeve kryesore mjekësore, në harmoni me planin për kujdestari (nga 24:00 deri 07:00), të hartuar në bashkëveprim me Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, do të kujdestarojnë 24 orë pa ndërprerë.

13.4. Orari i kujdestarisë do të publikohet në qendrat mjekësore, barnatore dhe ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Neni 14

14.1. Të gjitha veprimtarit afariste të parapara me këtë Rregullore nuk punojnë gjatë festave zyrtare të Republikës së Kosovës.

14.2. Përjashtim nga paragrafi paraparak kanë veprimtarit hoteliere, furrat e bukës, sallonet e ondulimit, veprimtarit shëndetësore, pikat e shitjes së karburantit dhe subjektet afariste me veprimtari të veçanta për të cilat merret pëlqimi paraparak nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik.

Neni 15

Zgjatja e Orarit të Punës

15.1. Për punën më të gjatë se orari i paraparë, duhet marrë pëlqimin paraparak nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në pajtim me kriteret e caktuara me këtë Rregullore;

15.2. Kërkesa nga veprimtarit afariste për zgjatjen e orarit të punës duhet të parashtrohet 48 orë më parë, në ditët zyrtare të punës.

15.3. Veprimtarive afariste të cilave iu lejohet zgjatja e orarit të punës në bazë të pagesës përkatëse janë:

- a. Hotelet, motelet dhe restorantet, mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00;
- b. Kafenet dhe disko-klubet në zonat para-urbane mund të zgjasin orarin deri në ora 02:00, ndërsa për ato në zonën urbane nuk lejohet zgjatja e orarit;
- c. Furrat e bukës, gjellëtoret dhe qebaptoret, mund të zgjasin orarin e punës deri në ora 02:00;
- ç. Dyqanet tregtare ushqimore, supermarketet, si dhe kiosqet, mund të punojnë 24 orë, me pëlqim paraparak nga Drejtoria për Zhvillim Ekonomik;

d. Veprimtarit afariste të ondullimit dhe floktoret, mund të fillojnë punën nga ora 4:00, me pagesë 5.00 € për orë apo pagesë mujore 50.00 €;

dh. Ordinancat private mund të punojnë pa ndërprerë (24 orë), me pagesë mujore 100.00 €;

e. Orari i punës së aktiviteteve për organizimet e ndërmarra nga Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ), subjektet fetare, subjektet politike dhe të ngjashme mund të zgjatet deri në orën 02:00, vetëm nëse aktiviteti ka qëllim kulturor, social, humanitar apo të ngjashme. Në këto raste zgjatja e orarit të aktivitetit mundësohet pa pagesë.

f. Ndërmarrjet ndërtimore, në raste të veçanta për shkak të natyrës së punëve, me pëlqim paraprak nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, mund të punojnë me orar të zgjatur deri në orën 20:00, me pagesë 5.00 € për orë apo pagesë mujore 100.00 €;

15.4. Veprimtarit afariste të cekura në paragrafin 15.3 të këtij Neni, ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjithmonë në pajtim me Ligjin për Rendin dhe Qetësinë Publike, si dhe Ligjin për Mbrojtje nga Zhurma.

15.5. Të gjitha pagesat për zgjatje të orarit nën pikën a, b, c dhe ç bëhen sipas Nenit 8 të Rregullores për Taksa, Tarifa dhe ngarkesa komunale numër 01.nr.011-43964 të datës 06.07.2015.

Neni 16

16.1. Kriteret dhe dokumentet të nevojshme për aplikim të zgjatjes së orarit janë:

- a. Plotësimi i formularit për zgjatje të orarit;
- b. Për zgjatje mujore të orarit, duhet të specifikohen datat sipas planit mujor të punës.
- c. Certifikata e biznesit (kopje);
- d. Leja e pronarit apo personit të autorizuar (kopje);
- e. Vendimi për plotësimin e kushteve minimale higjiene-teknike sanitare të lokalit (kopje);
- f. Për aktivitet e organizuara në hapësirat publike nevojitet pëlqimi për shfrytëzim, nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit;
- g. Të plotësojnë kushtet për parkim;
- h. Të plotësohen kushtet për qarkullimin të lirë të transportit;
- i. Paga për zgjatje të orarit.

16.2. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik e mban të drejtën e kërkimit të dokumenteve tjera shtesë sipas nevojës.

16.3. Çdo pëlqim të zgjatjes së orarit të punës, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik duhet të dërgoj pranë Drejtorisë për Punë Inspektuese dhe Policisë të Kosovës - Gjakovë.

16.4. Veprimtarit afariste dhe OJQ-të, pas përfundimit të zgjatjes së orarit duhet të bëjnë pastrimin e hapësirës përreth lokalit.

Neni 17

Mbikëqyrja

Për mbikëqyrjen e kësaj Rregullore kujdeset Drejtoria për Punë Inspektuese në bashkëpunim me Policinë e Kosovës - Gjakovë.

Neni 18

Dispozitat Ndëshkuese

18.1. Personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik gjobitet nga Inspektori i Tregut në shumë 10 (dhjetë) – 100 (njëqind) Euro, nëse vepron në kundërshtim me këtë Rregullore.

18.2. Personi fizik që ushtron biznes individual gjobitet nga Inspektori i Tregut në shumë 30 (tridhjetë) – 250 (dyqindpesëdhjetë) Euro, nëse vepron në kundërshtim me këtë Rregullore.

18.3. Personi juridik gjobitet nga Inspektori i Tregut në shume 100 (njëqind) – 1500 (njëmijepesëqind) Euro, nëse nuk respekton orarin e përcaktuar të punës, nëse vepron në kundërshtim me këtë Rregullore.

18.4. Drejtoria për Zhvillim Ekonomik mban të drejtën që në rast të mos respektimit të kodit afarist, rrezikimit të sigurisë së qytetarëve si dhe prishjes së qetësisë t'u merr pëlqimin për zgjatjen e orarit të punës.

18.5. Nëse Inspektori i Tregut gjatë inspektimit konstaton se veprimtaria afariste nuk e respekton orarin e rregullt të punës të paraparë me këtë Rregullore, mund të ndaloj përkohësisht ushtrimin e veprimtarisë.

Neni 19

Dispozitat Kalimtare

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore komunale shfuqizohet Rregullorja për "Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste dhe OJQ-ve në Komunën e Gjakovës" me numër: 01-/011- 37977 të dt. 04.06.2015.

Neni 20

20.1. Të gjitha bizneset dhe OJQ-të janë të obliguara që të harmonizojnë orarin e punës me dispozitat e kësaj Rregullore në afatin prej dhjetë ditë kalendarike (10) nga dita e hyrjes në fuqi.

20.2. Për bizneset të cilat nuk janë përfshirë në ndonjërin kategori të kësaj Rregullore, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik është përgjegjëse që më vendim të posaçëm dhe në harmoni dhe bashkëveprim me organet kompetente komunale, tua përcaktoj orarin e punës.

Neni 21

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Gjakovës dhe 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Kuvendi i Komunës së Gjakovës

01 Nr. MC/04-16337

Dt. 06.07.2017



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Z. Luan Gola